

ARSIMI NË SHTETIN SHQIPTAR GJATË VITEVE 1945-1967

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I HISTORISË  
NGA  
BERAT DEMOLLI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
PRISHTINË

QERSHOR, 2023

## REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

**Mentori:** *Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi*

**Kandidati:** *Berat Demolli*

**Tema:** *Arsimi në shtetin shqiptar gjatë viteve 1945-1967*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: “Arsimi në shtetin shqiptar gjatë viteve 1945-1967”. Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Punimi në fjalë përmban tre kapituj:

- Në kapitullin e parë me titull “**ORGANIZIMI I SISTEMIT ARSIMOR PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**”, është trajtuar çështja e arsimit në Shqipëri gjatë luftës së Dytë Botërore dhe vitet e para të pasluftës, kur komunistët erdhën në pushtet, duke përfshirë Reformën Arsimore (1946) si një nga veprimet e para të komunistëve. Në dy nënkapitujt e fundit janë trajtuar temat rreth heqjes së ndikimit fetar në sistemin arsimor si dhe lufta kundër analfabetizmit dhe veprimet që morën komunistët për zhdukjen e kësaj dukurie.
- Në kapitullin e dytë të titulluar “**SISTEMI ARSIMOR GJATË VITEVE '50**”, trajtohet gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm gjatë viteve të '50. Pastaj vazhdon me Institutet e larta të cilat ishin baza e arsimit të lartë në Shqipëri. Nënkapitulli i fundit trajton themelimin e Universitetit të Tiranës, që njëkohësisht është edhe Universiteti i parë shqiptar.
- Në kapitullin e tretë me titull “**ZHVILLIMI I ARSIMIT GJATË VITEVE 1958-1967**”, janë paraqitur zhvillimet në sistemin arsimor gjatë viteve '60, duke përfshirë këtu Riorganizimin e sistemit arsimor (1963), për të vazhduar më pas me forcimin e ideologjisë marksiste-leniniste në shkolla. Kapitulli përfundon me reformën e tretë, Revolucionarizmin e mëtejshëm të shkollës (1967), e cila është edhe ndryshimi i fundit në sistemin arsimor gjatë kësaj periudhe.

Në këtë hulumtim sa i përket metodave hulumtuese kemi përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për ta finalizuar hulumtimin në fjalë kemi përdorur metodat analitike dhe krahasimore.

Në kuadër të punimit kemi ngritur tri hipoteza:

1. Reformat arsimore që u ndërmorrën gjatë kësaj periudhe e plotësonin njëra-tjetrën.
2. Komunistët i dhanë një rëndësi të veçantë arsimit, në mënyrë që përmes tij të përhapnin ideologjinë marksiste-leniniste dhe të forconin pozitën e tyre në vend.
3. Shkalla e lartë e analfabetizmit në Shqipëri ishte një nga problemet më serioze të arsimit, por komunistët ndërmorën masa konkrete për zgjidhjen e këtij problemi.